

## ■ Shërbimet e Departamentit të Integritimit

- Qendër kontakti për çdo pyetje lidhur me migrimin dhe integrimin
- Këshillim individual për integrimin e migrantëve, pavarësisht nga prejardhja apo koha e qëndrimit në Gjermani
- Bashkëpunim dhe mbështetje vullnetarëve apo të interesuarve në fushën e migracionit dhe integritimit
- Këshillim të përshtatur për çështjet arsimore dhe mbështetje në njohjen e kualifikimeve të huaja
- Koordinim dhe rrjetizim i aktorëve rajonal në fushën e arsimit dhe integritimit të migrantëve
- Promovim i një shoqërie të hapur duke krijuar transparencë në procesin e integritimit

## ■ Kontakti

08441 27-2961

Löwenstr. 2 – 85276 Pfaffenhofen a.d.Ilm

Integration@landratsamt-paf.de

Landratsamt Pfaffenhofen a.d.Ilm

Autori: Landkreis Pfaffenhofen a.d.Ilm  
Hauptplatz 22, 85276 Pfaffenhofen a.d.Ilm  
Tel.: 08441 27-0 | Fax: 08441 27-271  
poststelle@landratsamt-paf.de

Foto: © pixabay  
Shënim: Të gjitha shërbimet e departamentit i nënshtrohen dispozitave ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.

Data: 2020



## ■ Zyra e konsulencës për çështjet e integritimit

Shërbimi i kësaj zyre synon këshillimin, pra planifikimin, mbështetjen dhe shoqërimin e duhur të çdo klienti përgjatë procesit të integritimit. Në kuadër të kësaj ne ofrojmë orientim lidhur me proceset sociale, si dhe ndërmjetësimin e ofertave nga rajoni.

Këshillimi ynë është gjithmonë konfidencial dhe falas për të gjithë banorët e qarkut.

### ■ Ne ju mbështesim...

- për akses në kursin e gjuhës, në arsimim, në punësim dhe në pjesëmarrje sociale
- në lidhje me çështjet institucionale dhe administrative
- me informacione në lidhje me jetesën në rajon

### ■ Kontakti

08441 27-2960 | Integrationsberatung@landratsamt-paf.de

## ■ Zyra e koordinimit të vullnetarëve

Koordinatorët e integritimit ofrojnë ndihmë dhe këshillim të gjithë vullnetarëve në fushën e migrimit dhe integritimit. Kjo ofertë shtrihet nga transferimi i njohurive profesionale, duke vazhduar me shoqërimin e projektideve tuaja deri tek ndërmjetësimi i detyrave vullnetare.

### ■ Ne ju mbështesim...

- gjatë punës tuaj vullnetare në qark dhe komuna
- në pjesëmarrjen apo organizimin e projekteve rajonale
- në nevojat e trajnimeve të mëtejshme, për rrjetizim apo për sqarim rreth çështjeve teknike

### ■ Kontakti

08441 27-2964 | Integrationslotsen@landratsamt-paf.de

## ■ Zyra e konsulencës për çështjet arsimore

Zyra jonë i ofron të gjithë migrantëve një orientim në sistemin shkollor të Bavarisë, si edhe në infrastrukturën arsimore rajonale. Ne ju mbështesim në planifikimin e rrugëtimit arsimor, duke filluar nga arsimi parashkollor, duke vazhduar me atë parauniversitar dhe duke e përmbyllur me arsimin e lartë apo atë akademik. Ne ofrojmë gjithashtu shërbimin e këshillimit për njohjen e diplomave apo kualifikimeve.

### ■ Ne ju mbështesim...

- në orientimin fillestar lidhur me çështjet e arsimit parashkollor, bazë, të mesëm dhe të lartë
- në planifikimin e rrugëtimit individual arsimor
- në njohjen e diplomave dhe kualifikimeve të huaja

### ■ Kontakti

08441 27-2967 | Bildungsberatung@landratsamt-paf.de

## ■ Zyra e koordinimit për çështjet e arsimore

Zyra jonë ofron ndihmë të gjithë migrantëve dhe sipërmarrjeve lokale lidhur me çështjet e formimit gjuhësor, të orientimit apo formimit profesional, të kurseve kualifikuese apo të trajnimeve profesionale. Ne shoqërojmë punëmarrësit që nga faza e planifikimit deri tek arritja e kualifikimit të synuar, si dhe i përkrahim në integrimin e mëtejshëm në tregun e punës.

### ■ Ne ju mbështesim...

- në orientimin drejt arsimit profesional dhe tregut të punës
- në planifikimin e rritjes profesionale dhe në specializimet e mëtejshme
- në integrimin e migrantëve në përditshmërinë e punës

### ■ Kontakti

08441 27-2965 | Bildungskoordination@landratsamt-paf.de